



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

21446
Nr. ____ Prot

Shkodër, më 21.10. 2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt- vendimi “Për miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të tij në Bashkinë Shkodër”.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkangjitur ju dergojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “Për miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të tij në Bashkinë Shkodër”.

Duke ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Alban PREKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .

“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË, SI DHE TË MËNYRËS SË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË TIJ NË BASHKINË SHKODËR”

Këshill Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës _____, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 germa (k) të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 10 pika 3 të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, i ndryshuar; VKM -së Nr.969, datë 02.12.2020 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij “; VKM-së Nr.681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”; si dhe relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër me nr _____, datë _____,

VENDOSI:

1. Të miratojë shfuqizimin vendimit nr.19 datë 20.07.2023, “Për Miratimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij në bashkinë Shkodër”.
2. Të miratojë rregulloren për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë (në vijim KVR), si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij në bashkinë Shkodër, sipas dokumentit bashkëlidhur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/ KRYETAR

Alban PREKA



Zv. Kryetar

Teuta QTC89
QTC89

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Rinisë

Edita Shashi Shashif

*Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore
dhe Shërbimeve Mbështetëse*

G. Dume G. Dume

Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Artënde Krip
Artënde Krip

Drejtoria Juridike

B. Xhepepe B. Xhepepe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR**

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË
ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË, SI DHE TË MËNYRËS SË
ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË TIJ NË BASHKINË SHKODËR**

Qëllimi dhe funksioni i Këshillit Vendor të Rinisë

1. Këshilli Vendor i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshilli Vendor i Rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
- b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor; c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
- ç) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë;
- d) jep mendim për politikat dhe çështjet e tjera vendore me ndikim mbi të rinjtë, sipas kërkesës së bashkisë.

2. Këshilli Vendor i Rinisë përbëhet nga një numër anëtarësh, që llogaritet në një të tretën e numrit në fuqi të anëtarëve të këshillit bashkiak (17 anëtarë), ku të paktën dy të tretat e anëtarëve përfaqësojnë të rinjtë (11 anëtarë). Këshilli bashkëkryesohet nga kryetari i bashkisë dhe njëri nga anëtarët e tij, që përfaqëson të rinjtë. Anëtarët e Këshillit Vendor të Rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.

2/1. Veprimtaria e Këshillit Vendor të Rinisë financohet:

- a) nga bashkia, bazuar në legjislacionin në fuqi;
- b) nga institucioni përgjegjës për rininë, bazuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të tij.

3. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe kompensimit të shpenzimeve së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Vendor të Rinisë miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke iu referuar, për atë që është e mundur, kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.

A. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë në Bashkinë Shkodër:

- 1. Këshilli Vendor i Rinisë përbëhet nga një numër anëtarësh, që llogaritet në një të tretën e numrit në fuqi të anëtarëve të këshillit bashkiak, ku të paktën dy të tretat e anëtarëve përfaqësojnë të rinjtë.
- 2. Këshilli bashkëkryesohet nga kryetari i bashkisë dhe njëri nga anëtarët e tij, që përfaqëson të rinjtë.
- 3. Anëtarët e KVR-së emërohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe mandati i tyre është dy vjeçar, me të drejtë riemërimi.
- 4. Anëtari i KVR-së mund të japë dorëheqjen në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim Kryetarin dhe përfaqësuesin e të rinjve. Anëtari i dorëhequr është i detyruar të

- përmbushë të gjitha detyrimet e lëna deri në miratimin e urdhërit të ndryshimit.
5. Anëtarët e KVR-së duhet të deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 6. Anëtarët e KVR-së, (17 anëtarë), ku të paktën dy të tretat e anëtarëve përfaqësojnë të rinjtë (11 anëtarë), kryejnë detyrën e tyre bazuar në parimin e mos-diskriminimit, të meritës, transparencës dhe gjithë-përfshirjes.

B. Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë në Bashkinë Shkodër

1. Kandidatët për anëtar të KVR-së identifikohen dhe shprehin interesin në bazë të një thirrje për shprehje interesi për të marrë pjesë në KVR për një mandat dy vjeçar, të njoftuar nga Kryetari, në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e Bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit;
2. Përzgjedhja mes individëve që kanë shprehur interes bëhet nga një komision i ngritur nga Kryetari duke u bazuar në kriterin e përvojës së mëparshme në sektorin e rinisë;
3. Komisioni përbëhet nga pesë (5) individ përfaqësues të nivelit drejtues nga Bashkia, përfaqësues të nivelit drejtues nga organizatat joqeveritare, përfaqësues nga sistemi arsimor në Bashkinë Shkodër, me ftesë nga kryetari.
4. Kandidati për anëtar të KVR-së, përfaqësues i organizatave rinore, duhet të plotësojë këto kritere:
 - a. të ketë dhënë kontribut në fushën e rinisë të paktën për 2 (dy) vitet e fundit, nëpërmjet projekteve me fokus rininë apo të zhvillimit të nismave ose të aktiviteteve
 - b. për promovimin e të rinjve;
 - c. të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - d. të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore
1. Kandidati për anëtar të KVR-së, jo përfaqësues i organizatave rinore, duhet të plotësojë këto kritere:
 - a. të ketë dhënë kontribut në fushën e rinisë të paktën për 2 vitet e fundit;
 - b. të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c. të ketë përvojë pune në fushën e zhvillimit apo të zbatimit të aktiviteteve rinore, apo të ketë qenë pjesë e nismave ose aktiviteteve për promovimin e të rinjve;
 - d. të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe të dispozitave ligjore në fuqi.
2. Kandidati, për t'u emëruar anëtar i KVR-së, duhet të paraqesë, përkatësisht, dokumentacionin si vijon:
 - a. kandidati, përfaqësues i organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë:
 - i. kërkesën;
 - ii. jetëshkrimin;
 - iii. fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë jetëshkrimin;
 - iv. vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
 - v. vetëdeklarimin e konfliktit të interesit;
 - vi. NIPT të organizatës që përfaqëson;
 - vii. jetëshkrim të organizatës

- b. kandidati, jo përfaqësues i organizatave rinore:
 - i. kërkesën;
 - ii. jetëshkrimin (CV: fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë jetëshkrimin)
 - iii. vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
 - iv. letër motivimi;
 - v. vetë-deklarimin e konfliktit të interesit
5. Thirrja për aplikim për kandidaturat e përmendura të këtij vendimi, publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër: www.bashkiashkoder.gov.al, nga mandati i parë, për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh.
 6. Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e tyre bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së aplikimeve.
 7. Rezultati i përzgjedhjes nga komisioni i ngritur do shpallet nga Kryetari i Bashkisë dhe publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër: www.bashkiashkoder.gov.al për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

C. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit Vendor të Rinisë

1. Këshilli Vendor i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshilli Vendor i Rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme, sipas Ligjit 75/2019 “Për Rininë” i ndryshuar, neni 10, pika 1:
 - a. këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
 - b. vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
 - c. propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
 - ç. bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë;
 - d. jep mendim për politikat dhe çështjet e tjera vendore me ndikim mbi të rinjtë, sipas kërkesës së bashkisë.
- KVR-ja mbledhet jo më pak se 4 (herë) herë në vit.
2. Mbledhja e KVR-së zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën gjysma (1/2) e anëtarëve të saj.
 3. Veprimtaria e KVR mbështetet nga Sekretariati teknik i cili përbëhet nga (1) një ose më shumë punonjës të bashkisë. Caktimi i sekretariatit teknik dhe procedura e thirrjes së mbledhjes apo elemente të tjera për funksionimin e KVR-së përcaktohen në rregulloren e brendshme, e cila miratohet nga Kryetari i Bashkisë për rininë.
 4. Sekretariati teknik thërret mbledhjet në bazë të nevojave që shprehen nga radhët e kryetarëve ose të anëtarëve.
 5. Sekretariati teknik njofton anëtarët e KVR-së, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen (data, ora, vendi), me anë të e-mail: info@shkodrarinore.gov.al.
 6. Sekretariati teknik mban proces verbalin dhe çdo komunikim tjetër që lidhet me

- KVR-në. Procesverbali nënshkruhet nga çdo pjesëmarrës prezent në mbledhjen KVR-së.
7. Mbledhjet e KVR-së zhvillohen kur janë të pranishëm të paktën gjysma (1/2) e anëtarëve të saj. Nëse nuk paraqiten në mbledhje numri minimal i anëtarëve pjesëmarrës, takimi shtyhet për një datë të mëvonshme.
 8. Mandati i anëtarit të KVR-së mbaron kur:
 - a. përfundon afati dy-vjeçar nga data e emërimit;
 - b. humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate apo dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c. jep dorëheqjen.
 9. Anëtari i Këshillit Vendor të Rinisë lirohet nga detyra, para mandatit, nga dy bashkëkryesuesit e KVR-së me më shumë se $\frac{1}{2}$ e votave, në rastet kur:
 - a. nuk paraqitet, pa shkaqe të justifikuara, në të paktën 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme të KVR-së;
 - b. paraqiten shkaqe objektive, që e bëjnë të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara; c. nuk përmbush detyrimet si anëtar i KVR-së;
 - c. veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KVR-së;
 - d. përfundon afati dy-vjeçar nga data e emërimit.
 10. Anëtari i KVR-së, të cilit i është ndërprerë mandati apo është liruar nga detyra, zëvendësohet nga kryesuesit dhe sekretariati teknik me një kandidat që përmbush kriteret e përcaktuara në këtë vendim, i cili ka qenë i kandiduar.
 11. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit zëvendësues është sa pjesa e mbetur e mandatit të anëtarit të larguar.
 12. Anëtari pajiset me referencë të lëshuar nga Kryetari i Bashkisë për kontributin e dhënë në sektorin e rinisë.
 13. Të miratojë detyrat e Këshillit Vendor të Rinisë si më poshtë:
 - a. Promovon projektet dhe iniciativat për të rinjtë iniciuar nga Bashkia Shkodër dhe nga organizatat e shoqërisë civile;
 - b. Këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
 - c. Vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
 - d. Nxitë takime, diskutime me të rinjtë në gjithë territorin e Bashkisë Shkodër;
 - e. Propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
 - f. Merr pjesë në trajnimet e propozuara nga aktorët publik dhe jopublik për ngritjen e kapaciteteve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ 2025

RELACION

“Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij në Bashkinë Shkodër”.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

“E ardhmja e qytetit formohet nga të rinjtë e tij. Ne nuk mund të ndërtojmë gjithmonë të ardhmen për të rinjtë tanë, por mund të ndërtojmë të rinjtë tanë për të ardhmen.”

Bashkia Shkodër, në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, të ndryshuar me Ligjin nr. 24/2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2019, ‘Për rininë’”, dhe me synimin për të garantuar pjesëmarrjen aktive të të rinjve në vendimmarrje, ka ndërmarrë hapat për ngritjen e Këshillit Vendor të Rinisë, si një strukturë këshilluese që siguron pjesëmarrjen aktive të të rinjve në proceset vendimmarrëse vendore.

Duke qenë se është e nevojshme të përshtaten procedurat me ndryshimet ligjore dhe praktikat më të mira, paraqitet projekt-vendimi për miratim, i cili përmban Shfuqizimin e vendimit nr. 19, datë 20.07.2023, “Për miratimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij në Bashkinë Shkodër”. pasi përmbajtja e tij nuk është më në përputhje me

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

ndryshimet ligjore të fundit dhe miratimin e rregullores së re për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë (në vijim KVR), si dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të tij në Bashkinë Shkodër.

Këshilli Vendor i Rinisë do të shërbejë si urë bashkëpunimi midis të rinjve, organizatave rinore dhe institucioneve vendore, duke kontribuar në hartimin e politikave që lidhen me zhvillimin, mirëqenien dhe përfshirjen e tyre në jetën shoqërore, kulturore e ekonomike bazuar në sa më sipër, propozojmë para Këshillit Bashkiak:

Miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij në Bashkinë Shkodër.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Alban PREKA



Drejtoria e Përgjithshme Sociale dhe e Rinisë

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë,

Strehimit dhe Shëndetit Publik

Konceptoi: H. Tafilica